

TRUSTORJA

KRYETITUJT E KËTIJ NUMRI

- * TM3: investimet në ngritje (faqe 2)
- * Shtohen 4 fonde të reja investive (faqe 3)
- * Miratohet buxheti dhe tarifa e re (faqe 3)
- * Mjetet e pabarazuara në rënie (faqe 4)

FAKTET KRYESORE

Më 30 shtator 2014

Çmimi i aksionit	€1.2655
Mjete nën menaxhim	€1,038,397,895
Pensione të shpaguara në tremujor	€3.04 mln
Pensiona të shpaguara për 2014	€11.04 mln
Llogari të kontribuuesve	469,489

INVESTIMET


Çmimi i aksionit:

Korrik	0.11%
Gusht	1.40%
Shtator	-0.21%
Gjithsej performanca neto	1.30%

Kthimi bruto:


Korrik	€1.56 mln
Gusht	€14.68 mln
Shtator	€-1.79 mln
Gjithsej kthimi bruto	€14.44 mln

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË NGA THEMELIMI



Periudha	1M	3M	Viti	1V	5V	Nga themelimi
Rezultati	-0.21%	1.30%	4.44%	7.86%	32.38%	26.55%

PLASMANI I MJETEVE NË FUND TË TREMUJORIT



PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE DHE LV KOSOVË NË TREMUJOR

1. VANGUARD ▲ +0.67%	4. AXA GILB ▲ +0.73%	7. LV - KOSOVË ▲ +0.64%
2. SCHRODERS ▲ +3.67%	5. BNY MELLON ▲ +1.18%	8. Nordea GSEF ▲ +8.14%
3. ECM-DEC ▲ +0.03%	6. ALCEDA ▼ -1.15%	9. Nordea SRF ▲ +3.17%

Shënim: Fondet e KBI, AXA WFOI, PICTET dhe TOBAM deri në datën e raportimit nuk i kishin mbushur 3 muajt të operimit. Performanca e tyre në vlerë është prezantuar në në faqen 2 të këtij numri.

BOTUES: Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës - Botuar: tetor 2014

Autor: Jeton Demi

Kontakt: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10, 10000 Prishtinë - 038-244-341 - info@trusti.org - www.trusti.org

€14 MLN KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM3

FKPK-ja e mbylli tremujorin e tretë (TM3) të 2014-s me një kthim bruto nga investimet prej rreth €14 mln. Në këtë mënyrë, kthimi vjetor bruto nga investimet, bashkë me kthimet nga dy tremujorët paraprak, shkon kështu në rreth €46 mln. Performanca pozitive e investimeve në TM3 ndikoi në rritjen e çmimit të aksionit për 1.30% i cili arriti në €1.2655. Kështu çmimi i aksionit në fund të këtij nëntëmujori rezultoi të jetë rritur për 4.44% nga fillimi i vitit.

Mjetet nën menaxhim në fund të periudhës tejkaluan shifrën €1,038 miliardë (TM2: €996 mln) duke u ngritur kështu për €42 mln. Rritja e mjeteve nën menaxhim u ndikua më shumë nga kontributet e reja (€33 mln) dhe pjesa tjetër nga kthimi nga investimet (€14 mln). Në anën tjetër FKPK shpagoi pensione prej €3.04 mln, ndali për tarifën menaxhuese €1.36 mln dhe refondoi €0.12 mln, duke iu zbritur kështu mjeteve nën menaxhim rreth €4.53 mln.

Faktorët me ndikim

Tregjet financiare globale pësuan lëkundje gjatë tremujorit të tretë. Tregu i aksioneve u ndikua negativisht nga rritja e tensioneve globale në terma të dollarit amerikan. Tensionet politike në Lindjen e Mesme dhe Ukrainë, bashkë me të dhënat dekurajuese të rritjes ekonomike në Evropë e Kinë, rritën ndjeshmërinë e investitorëve dhe, si pasojë, shtuan luhatshmërinë e tregjeve. Ndonëse ekonomia e Japonisë, e bazuar në eksporte, dha shenja të forcimit nga dobësimi i Yen-it, por kjo u kompensua negativisht nga pasiguritë e zgjedhjeve në Brazil, si një nga vendet më të rëndësishme të tregjeve në zhvillim. Megjithatë, ishin kryesisht raportet pozitive të rritjes ekonomike të SHBA-ve dhe të korporatave

1.30%

kthimi nga investimet në TM3

që e mbajtën indeksin kryesor të bursave, S&P500, në anën pozitive edhe këtë tremujor. Si rezultat, luhatjet në tregjet financiare u reflektuan kështu në lëvizjen e çmimit të aksionit përgjatë tremujorit: korriku (+0.11%), gushti (+1.40%) dhe shtatori (-0.21%).

Performanca e fondeve investuese

Vlerësuar në përgjithësi, fondet investuese të portofolit të FKPK-së, përveç fondeve të Tobam (-1.86%) dhe Alceda (-1.15%), ishin me performancë pozitive. Dukshëm më e dalluar ishte performanca e Nordea 1-GSEF (+8.14%), fond ky i përqendruar në aksione kryesisht të pozicionuara në SHBA (61% e portofolit) dhe në sektor me rritje, si TI dhe kujdesi shëndetësor. Ndërsa jo keq ishte performanca e portofolit të Schroders (+3.67%), kryesisht në bono, i cili përfitoi nga rritja e riskut në tregut e aksioneve; por edhe fondi tjetër i Nordea, 1-SRF (+3.17%), i multi-aseteve, gjithashtu me përqendrim të lartë gjeografik në SHBA (62%) dhe në sektorë të TI e kujdesit shëndetësor. Fondi i Vanguard, megjithëse pozitiv (+0.65), nuk përfitoi nga përqendrimi i portofolit në SHBA (56%) për shkak se 1/3 e portofolit ishte e alokuar në industrinë financiare dhe energji, sektorë këta me performancë jo të mirë në TM3. Ndërsa performanca e fondeve të tjera investuese - KBI, Pictet, BNY Mellon, AXA GILB, ECM - nuk kishte dallime të mëdha, megjithëse portofolet e tyre investuese ndryshojnë mjaft.

Tabela 1: Performanca investuese në TM3 2014 dhe plasmanet investuese në fund të tremujorit

Menaxhuesi/ Entiteti/Emetuesi	Emri i fondit/instrumentit	Plasmanet	Kthimi bruto
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€102,322,905	€3,623,350
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€332,699,684	€2,426,407
Nordea	1-Stable Return Fund	€86,864,408	€2,441,860
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€32,441,860	€1,734,285
KBI ²	Divident Plus	€41,658,306	€1,730,510
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€165,218,660	€1,543,825
Pictet ³	High dividend selection Z EUR	€30,621,708	€621,708
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€61,326,946	€508,546
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€62,015,420	€232,378
ECM	Diversified European Credit	€24,338,547	€36,997
AXA ³	WF Optimal Income I EUR	€25,985,805	€11,113
TOBAM ¹	Anti-benchmark WEFE hedged share class	€34,832,717	-€134,508
Alceda	Aquila Risk Parity 7 Fund	€28,484,914	-€332,406
Gjithsej²		€1,028,811,881	€14,444,065

¹ Performanca e këtyra fondeve nuk është për gjithë tremujorin TM3, pasi investimet janë kryer gjatë kësaj periudhe. ² Këtu nuk përfshihet shuma prej 9,971,669 euro në fund të TM3 që ishte e depozituar në llogarinë e FKPK-së në BQK. Për informacione të detajuara financiare për TM3 ju lutemi shfletoni raportet duke kopjuar në internet adresën vijuese: www.trusti.org/index.php/sq/raportet-tremujore

KATËR FONDE TË REJA I SHTOHEN PORTOFOLIT INVESTUES: KBI, AXA WFOI, PICTET DHE TOBAM

Bordi Drejtues i FKPK-së gjatë TM3 ka realizuar investime reja në katër fonde të hapura investuese, sipas strategjisë investuese në fuqi prej dhjetorit 2013. Vlera e investuar në këto fonde deri në fund të TM3 ishte: KBI (€40 mln), AXA WFOI (€26 mln), Pictet (€30 mln) dhe Tobam (€45 mln). Veç këtyre investimeve, gjatë këtij tremujori u shtuan edhe €45 mln tek fondi i Nordea 1-SRF dhe €25 mln tek fondi i BNY Mellon, ndërsa rreth €19 mln ishin investime të reja në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës - ku sakaq rreth 21 €mln kishin maturuar. Në total, ishin rreth €201 mln euro mjete të lëvizura drejt tregjeve financiare, në vazhdim të përmbushjes së strategjisë së re investuese, dhe rreth 19 mln ishin investime në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Fondet e reja investuese

Në vijim jepet prezantim i shkurtër i katër menaxhuesve të rinj të mjeteve, dhe veçorive të këtyre fondeve investuese, që kanë shtyrë Bordi t'i përzgjedhë ato.

Kleinwort Benson Investors (KBI) është me seli në Dublin të Irlandës, dhe është pjesë e Kleinwort Benson Group. Kjo ndërmarrje menaxhon mjetet e investitorëve institucionalë që nga 1980-a, dhe aktualisht ofron strategji të specializuara për skemat pensionale publike dhe të korporatave. Në fund të vitit 2013 Kleinwort Benson Investors kishte nën menaxhim €5.4 miliardë. FKPK-ja ka investuar për herë të parë në korrik të 2014-s në fondin e KBI: Institutional Dividend Plus Developed Equity Fund H EUR, fond ky aktiv i cili në përbërjen e tij përmban (dhe tregton me) aksione të korporatave botërore me dividendë stabile.

AXA Investmet Managers (AXA IM) është themeluar më 1994, me seli në Francë dhe është pjesë e korporatës AXA Group. Në fund të vitit 2013 AXA IM kishte nën menaxhim €547 miliardë, dhe 2,100 të punësuar në 30 shtete të Evropës, Amerikës, Azisë dhe Lindjes së Mesme. Për kujtim, FKPK-ja më 2010 kishte investuar nga fondin e AXA GILB.

PROPOZOHET TARIFA MENAXHUESE DHE MIRATOHET BUXHETI PËR 2015-N

Bordi i FKPK-së e ka miratuar buxhe-tin për vitin 2015, dhe ia ka dërguar Kuvendit tarifën e propozuar për miratim. Bordi ka vlerësuar, se bazuar në nevojat buxhetore të FKPK-së, por edhe në vlerën e suficitit të vitit 2014, financimi i aktiviteteve operacionale do të kërkojë ngarkimin e një tarifë operacionale prej 0.095% (2014: 0.13%) ndaj mjeteve nën menaxhim, ose €1.42 mln (2014: €1.48 mln); që është për

€220 mln

investime të realizuara gjatë TM3

Kurse nga korriku 2014 FKPK-ja ka investuar edhe në fondin tjetër të AXA-s, atë të AXA World Fund Optimal Income I EUR. Ky fond aktiv në përbërjen e tij përmban (dhe tregton me) aksione dhe fletobligacione, të korporatave dhe shteteve kryesisht evropiane, duke synuar kështu të gjenerojë kthim absolut nga të dy klasat e instrumenteve financiare në afat të gjatë. Përdorimi i derivativave në masë të vogël financiare lejohet, për hir të menaxhimit të riskut.

Tobam është me seli në Luksemburg dhe në fund të 2013-s i kishte 18 të punësuar dhe rreth \$5 miliardë mjete nën menaxhim. Tobam është themeluar më 2006 dhe aktualisht është në pronësi të vetë punonjësve. Tobam në filozofinë e tyre investuese janë kundër përdorimit të bençmarkut dhe ofrojnë kështu fonde investuese mbi këtë parim (anti-benchmark). FKPK-ja nga korriku 2014 ka filluar me investimet përmes fondit të Tobam Anti-benchmark World Equity Fund Euro-Hedged. Ky fond aktiv në përbërjen e tij ekskluzivisht përmban (dhe tregton me) aksione të korporatave botërore, ku përzgjedhja bazohet mbi arritjen e një korrelacioni sa më të ulët në mes të (performancave të) aksioneve të këtyre korporatave - me synim uljen e riskut të gjithmbarshëm.

Pictet është menaxhues i pasurive dhe mjeteve që është themeluar më 1806 në Gjenevë, Zvicër, duke qenë kështu një nga pionierët e menaxhimit të fondeve. Në fund të 2013-s Pictet kishte mbi €300 miliardë mjete nën menaxhim, dhe 3400 të punësuar në 26 vende të botës. FKPK-ja ka investuar për herë të parë në korrik të 2014-s në fondin investues të Pictet High Dividend Selection – Z Euro, fond ky aktiv i cili në përbërjen e tij përmban (dhe tregton me) aksione të korporatave botërore me dividendë stabile.

4.1% më pak se viti paraprak. Ndërsa për financimin e aktiviteteve investuese do të duhet të ngarkohet tarifa investuese prej 0.40% (2014: 0.40%), në vlerë prej €4.87 mln (2014: €3.77 mln). Rritja e buxhetit investues (prej €1.1 mln) do të mbulohet në pjesën më të madhe nga suficiti i vitit paraprak (€0.8 mln), dhe pjesa tjetër (€0.3 mln) nga tarifa e ngarkuar mbi më shumë mjete nën menaxhim.

€3 MLN PENSIONET E SHPAGUARA NË TM3

Vlera e pensioneve të shpaguara në TM3 ishte rreth 3 mln e cila shkoi në emër të 890 përfituesve. Në tremujorin para-prak, TM2, vlera e pensioneve të shpaguara ishte €4.2 mln në emër të 1,345 përfituesve. Pra ndërkohë që vlera e shpägimit ra me 34% numri i përfituesve ra me 28%. Analizuar sipas arsyes së shpägimit rezulton se: 83% e kësaj vlere iu shpägua 717 përfituesve të pensionit të moshës (TM2: 83%; 1,043 të pensionuarve), 15% të saj e tërhoqën trashëgimtarët e 140 kontribuuesve të vdekur (TM2: 15%, 254 trashëgimtarë), dhe 2% shkoi tek 33 përfituesit e pensionit të

36%

më shumë pensione të shpaguara se më 2013

invaliditetit (TM2: 2%; 48 përfitues). Krahasuar me nëntë-mujorin e vitit 2013 vlera e pensioneve të shpaguara për të njëjtën periudhë të këtij viti është rritur për 36%, përkatësisht nga €8.1 mln në €11.0 mln, dhe numri i përfituesve është rritur për 19%, nga 2,783 në 3,321, sipas periudhave përkatëse.

MBI 11 MIJË SHËRBIME TË OFRUARA NË TM3

Numri i shërbimeve të ofruara gjatë TM3 nga zyra e FKPK-së pësoi një rënie prej 13% krahasuar me TM2 (TM2: 12,765 shërbime). Kjo rënie është vënë re më së shumti tek numri i kërkesave për shërbimin eTrusti (-40%), shtypjen e pasqyrave të llogarive (-11%) dhe aplikimet për pension (-3%). Pjesa dërrmuese e shërbimeve ishin për: shtypjen e pasqyrave (56%), autorizimin e llogarive të reja në eTrusti (13%), aplikimin për pensionim (8%), ndryshimin e adresave (7%) dhe shtypjen e pasqyrave për punëdhënësit (6%). Njëkohësisht numri i shërbimeve të vetkryera nga kontribuuesit përbënin rreth 10% të totalit të shërbimeve (1,514 sosh). Përveç shërbimeve të ofruara, gjatë TM3 janë kthyer edhe

4,356 pasqyra vjetore të pashpërndara nga Posta e Kosovës për adresë të pasaktë të kontribuuesve përkatës. Të gjitha pasqyrat e kthyer janë në proces të regjistrimit dhe kontribuuesit që kanë llogari në eTrusti do ta shohin nën menyne "Aktivitete" pas kyçjes në llogari. Në total, për nëntë-mujorin e 2014, numri i shërbimeve të ofruara ka arritur në 43,759, ndërkohë që për gjithë vitin 2013 ishin ofruar 49,486 shërbime. Përveç nga zyra e FKPK-së, shërbime për kontribuuesit janë ofruar edhe zyrtarët pensionalë të ATK-së në të gjitha rajonet e vendit, dhe gjatë TM3 ishin 5,983 shërbime të tilla, nga të cilat 92% ishin për shtypjen e pasqyrave të llogarive.

KONTRIBUTET E PABARAZUARA BIEN NË 1.2% TË TOTALIT TË TË ARKËTUARAVE

Kontributet pensionale për të cilat FKPK-ja nuk ka informacion se kujt i takojnë (nga mosdërgimi i të dhënave nga punëdhënësit) ranë më tej gjatë TM3. Në përqindje mjetet e pabarazuara në llogaritë individuale të kontribuuesve tashmë përbëjnë vetëm 1.2% të totalit të kontributeve të arkëtuara, dhe në vlerë ato janë €11.35 mln (TM2 2014: €11.9 mln). Kjo njëherësh është në përputhje me objektivat

e vëna nga Bordi Drejtues për vitin 2014. Njëkohësisht, gjendja paraqitet shumë e kënaqshme edhe për vitin 2014, ku niveli i mjeteve të pabarazuara ka rënë në 0.31% (fundi i TM2: 0.36%), ose në vlerë €296 mijë nga rreth €96 mln kontribute të paguara për nëntë-mujorin e 2014-s. Për më shumë, një pjesë jo e vogël e kësaj shume janë gjoba dhe interesa të paguara gabimisht në llogarinë e FKPK-së.

eTRUSTI ME 35 MIJË PËRDORUES

Numri i përdoruesve të eTrustit kapi shifrën e 35,223 në fund të shtatorit. Megjithëse ritmi i rritjes ka rënë në 4.4% (kundrejt 10% në TM2), gjithsesi se fakti që për nëntë-mujorin e 2014-s numri i përdoruesve është shtuar për 50%, është një lëvizje e kuptueshme pas dy fushatave televizive informuese për këtë shërbim. Në total, për nëntë-mujorin e këtij viti, kontribuuesit i kanë vetkryer

8,711 shërbime, duke përbërë kështu 20% të totalit të shërbimeve të ofruara nga zyra e FKPK-së për të njëjtën periudhë. Edhe për këtë tremujor aktiviteti kryesor i kryer nga vet kontribuuesit ka qenë ai i ndryshimit të të dhënave të kontaktit: adresës, e-mailit, numrit telefonik. Përdorimi i këtij shërbimi gjithsesi se është në të mirë të FKPK-së dhe kontribuuesve.